

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“TOSKU” shpk

Në Tiranë, sot më datë 20 Dhjetor 2024,

Z.Kreshnik Shehaj, i biri i Fatmirit, i dtl. 20.04.1983, lindur në Fier dhe banues në Tiranë shtetas shqiptar, madhor me zotësi juridike për të vepruar, identifikuar sipas ligjit nëpërmjet letërnjoftimit ID me Nr. Personal **I30420130M**

të cilët me cilësinë e “Ortakëve Themelues”, me vullnet të lire, të plote e të sinqertë dhe iniciativën e lire private, mbështetur në Kushtetutën e Republikës se Shqipërisë, Kodin Civil në fuqi, në Ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008, “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare”, në Ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, vendosen krijimin dhe regjistrimin e shoqërisë **“TOSKU” shpk** me të dhënat e mëposhtme:

KREU I

Emërtimi, Forma Juridike, Selia, Kohëzgjatja, Objekti

Neni 1
Emërtimi

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është **“TOSKU” shpk**.

Neni 2
Forma Juridike

Shoqëria **“TOSKU” shpk**, është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë e quajtur “Shoqëria”), e themeluar nga personat fizikë të sipërpërmendur, të cilët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Secili ortak gjëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital.

Neni 3
Selia

Tiranë,Farkë,Lagjia Selite,Rruga Selite e Vjetër,pallati Brari,pasuria me nr 146/37-N3,zone kadastrale nr.3292,kati 1,Nr.2,prane kopeshtit Botanik.

Shoqëria mund të ndryshoje selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijoje filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërise, vetëm me vendim te Asamblese se Ortakut te Vetem.



Neni 4
Objekti

Shoqëria do të ketë objekt të veprimtarisë:

Ofrimi i sherbimit taksi.

Për kryerjen e aktiviteteve të shoqërisë së mësipërme për të cilin do të nevojitet leje përkatëse, shoqëria është e detyruar të pajiset paraprakisht me këtë leje nga organi kompetent.

Neni 5
Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e saj për një periudhe kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në QKB.

KREU II

KAPITALI

Neni 6
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 000 (një qind mijë) lekë. Ky kapital është i ndarë në 1 pjesë dhe vlera nominale e seciles pjesë është 100 000 (njëqind mijë) lekë.

Ky kapital zotërohet në masën 1 pjesë nga ortaku Z. Kreshnik Shehaj e barabartë me 100 % dhe vlerë 100 000 (njëqind mijë) lekë.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme. Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)


Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cenimit.

Neni 7
Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.



Ky statut kushtëzon kalimin e kuotave të tretëve jashtë shoqërise, me miratimin e shoqërisë dhe të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë, sipas modaliteteve dhe shumicës se cilesuar që kerkon ndryshimi i statutit.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qëndren Kombëtare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit".

Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8
Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendor në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9
Marrja e vendimeve

3 | F a q e

Asambleja e përgjithshme për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, vendos me votat e te pakten tri të katërtave te zoteruesve te kapitalit te shoqerise, qe jane pjesmarres ne mbledhje.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

Neni 10
Administrimi

Shoqëria do të administrohet nga një administrator. Kohëzgjatja e mandatit te Administratorit është 5 (pesë) vjet, me të drejtë ri-emërimi. Administrator i shoqërisë “TOSKU” shpk zgjidhet **Z.Kreshnik Shehaji**, i biri i Fatmirit, i dtl. 20.04.1983, lindur në Fier dhe banues në Tiranë shtetas shqiptar, madhor me zotësi juridike për të vepruar, identifikuar sipas ligjit nëpërmjet letërnjoftimit ID me Nr. Personal **I30420130M**.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti, apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

Përveç kësaj, administratori shkarkohet nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkeshë të çdonjërit prej ortakëve.

Tagrat e përfaqësimit të administratorit dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Neni 11
Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;



c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

ç) përgatisi dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme përmiratim;

d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur përmiratim, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;

e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë përmiratim; tregtare;

Administratori eshte i detyruar të thërrasi asamblenë e përgjithshme edhe ne rastet kur :

- Asambleja e përgjithshme thirret pasi, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe
- kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratori ka të drejte të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoritetet e shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori ka të gjitha kompetencat përmiratim, që ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rr Ethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj. Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretë e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretë nuk mund ta injoronin këtë akt në rr Ethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.


Neni 12
Viti Financiar

Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë finanziar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qëndren Kombëtare të Regjistrimit dhe mbylljet më 31 Dhjetor.

Neni 13
Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;



- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
 - ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit";
 - d) me vendim të gjykatës;
- Në këtë rast Asambleja e Ortakëve merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 (një) apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë " Shoqëri në likuidim e sipër ".

Neni 14
Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e saj në përputhje të plotë me statutin dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjeter specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 15

Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e statutit, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 16
Dispozita përfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua në 5 ekzemplare me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhën shqipe dhe pasi miratohet në parim dhe nen për nen nga Ortaku themelues i shoqërisë tregtare "**TOSKU**" shpk, dhe nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën origjinale.

ORTAKU VETËM THEMELUES

Kreshnik Shehaj

